

VENDIM
Nr.284, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT
KRUJË-KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit në kullimit të zonën e shërbimit të kullimit Krujë-Kurbin, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës që kullon me KUL, Thumanë-Borizanë (KRK-1, KRK-2), me sipërfaqe 21300 ha;

b) zona e kënetës Borizanë-Thumanë (KRK-3), që kullon me ngritje mekanike, me një sipërfaqe 1591 ha;

c) zona e fushës që kullon me përroin Bardharë (KRK-4), me sipërfaqe 1499 ha;

ç) zona e fushës Bacung-Dollakë-Tapizë (KRK-5, KRK-6), me sipërfaqe 3714 ha;

d) zona e fushës Bubq-Mallkuc (KRK-7), me sipërfaqe 2567 ha;

dh) zona e fushës së Thumanës, që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 8310 ha;

e) zona e fushës që kullon me KUL Gjormë-Zheje, Mamurras-lumi Drojë dhe KUL Laç-Milot (LAK-2, LAK-3, LAK-4), me sipërfaqe 1193 ha;

ë) zona e fushës që kullon me KK-1, Shullaz-Fushë, Milot-Gurrëz-ALK (LAK-5), me sipërfaqe 1459 ha;

f) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

g) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano